

SOCIALE

Familja Mateli nga Kamza padrejtësisht nuk trajtohet me ndihmë ekonomike nga qeveria



FAQE 5

INVESTIMI

Rruga "Mësonjëtorja" në lagjen 5 Kamzë, një nga 50 projektet e reja për vitin 2017



FAQE 6

SHQETËSIMI

OSHEE rrezikon jetën e banorëve të Kamzës, nuk përmbush detyrimet ndaj konsumatorëve



FAQE 7

SPORT

Kamza Karate nis stërvitjen intensive për vitin 2017, me synim arritjen e objektivave



FAQE 8



Gazetë e Bashkisë Kamzë

KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 194 janar 2017
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

Analizohet puna e drejtorive të Bashkisë Kamzë për vitin 2016

Kryebashkiaku Xhelal Mziu vlerëson me nota pozitive punën e Drejtorisë së Financës

FAQE 2-3

Kryebashkiaku Mziu vlerëson punën e Drejtorisë së Koordinimit-Zhvillimit

Faqe 3

Investimet në infrastrukturë, së shpejti nis ndërtimi i rrugës "Tomini" në lagjen 3 Bathore

Faqe 6

Rritje e aplikimeve dhe oponentë ligjore për refuzimet e padrejta të familjeve për ndihmë ekonomike

Faqe 5

Ujësjetës-Kanalizimet, tolerancë zero ndaj informalitetit

Faqe 7



Kryeministri nuk fton kryebashkiakun Mziu në takim me kryetarët e bashkive për projektet dhe bashkëpunimin me vendorët

FAQE 4



NË BRENDESI

Rruga "Abdi Bej Toptani" në Valias - investim i dobishëm për komunitetin

FAQE 6

Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Shoqatës së Bashkive

FAQE 4

Vetëvrasia e 31-vjeçarit në Kamzë për faturat e energjisë, tjetër tragjedi për "meritë" të "Rilindjes"

FAQE 5

Konferenca e Këshillit të Evropës/ Bashkia Kamzë, një nga pesë praktikantët më të mira në vend

FAQE 4

Kamza Basket, e përgatitur për t'u përballur me çdo kundërshtar në fazën e dytë

FAQE 8



Kryebashkiaku Xhelal Mziu vlerëson me nota pozitive punën e Drejtorisë së Financës për vitin 2016

Vlerësohet me nota pozitive puna e bërë nga stafi i Drejtorisë së Financës gjatë vitit 2016. Analiza e punës njëvjeçare nxori në pah arritjet e kësaj drejtorie. Kryebashkiaku Xhelal Mziu, pasi i përgëzoi specialistët e kësaj drejtorie për punën e bërë, i orientoi që duhet më tepër vëmendje dhe përqendrim për mirëmenaxhimin e financave të Bashkisë. Ndër qëllimet kryesore të kësaj drejtorie është rritja e të ardhurave të Bashkisë, me qëllimin për të rritur zërin e investimeve publike në shumë fusha jetike për qytetarët e Kamzës. Drejtorja e Financës duhet të jetë promotorja e përfitimit financiar, duke treguar edhe mënyrat dhe rrugët se si duhet arritur kjo. Një mënyrë është oponenca e fillimvitet që i bëhet Ministrisë së Financave për mirëplanifikimin e granteve, duke marrë mirë në konsideratë numrin e popullsisë që ka Bashkia Kamëz. Një vëmendje e rëndësishme duhet t'i kushtohet bashkëpunimit me Drejtorinë e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial në lidhje me përfitimin e projekteve që sigurojnë kapitale të rëndësishme financiare. Me gjithë larinë e rrugëve dhe mënyrave për të sjellë të ardhura, baza kryesore mbeten të ardhurat që krijojnë vetë Bashkia. Drejtorja e Financës është drejtorja kryesore që i referohet buxhetit dhe paketës fiskale. Po nga kjo drejtori duhet ndërhyrje për t'i zbatuar këto në mënyrën



më të mirë bazuar dhe në të gjitha aspektet ligjore. Për vitin në vazhdim duhet të mbahet në mbikëqyrje raporti i të ardhurave me shpenzimet, duke mbizotëruar të ardhurat, për të pasur një buxhet të fuqishëm financiar dhe e përkthyer kjo në rritjen e shkallës së investimeve, përfitues të të cilave janë qytetarët e Kamzës.


Realizimi i buxhetit të vitit 2016 përbën një moment të rëndësishëm për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive, përgatitjen e pasqyrave financiare e të tjera probleme që kanë të bëjnë me

financat e Bashkisë Kamëz për një periudhë njëvjeçare. Gjithashtu, nga kjo drejtori janë përpiluar në kohën dhe masën e duhur listëpagesat e ndihmës ekonomike si dhe të personave me aftësi të kufizuara. Është hartuar projektbuxheti i vitit 2017 sipas pasqyrave përkatëse në mënyrë të detajuar për çdo tregues të shpenzimeve dhe të ardhurave. Është hartuar situacioni progresiv i shpenzimeve dhe i të ardhurave për çdo muaj dhe është paraqitur në degën e Thesarit brenda afateve përkatëse. Janë dërguar në afatin e caktuar të gjitha evidencat e realizimit

Realizimi i buxhetit të vitit 2016 përbën një moment të rëndësishëm për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive, përgatitjen e pasqyrave financiare e të tjera probleme që kanë të bëjnë me financat e Bashkisë Kamëz për një periudhë njëvjeçare.

të investimeve në ministritë e linjës dhe në Prefekturë. Janë dërguar evidencat përkatëse në afatin e kërkuar pranë INSTAT-it. Një volum të madh pune ka zënë plotësimi i vërtetimeve të ndryshme si dhe i librezave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, si për punonjësit e arsimit, ashtu dhe të administratës së Bashkisë. Është përfunduar inventarizimi i pajisjeve dhe i materialeve si të Bashkisë ashtu dhe i shkollave.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, rezultate pozitive në vitin 2016



edhe debia e trashëguar, për të cilën duhen gjetur instrumentet e duhura për mbledhjen e saj. Për vitin 2016, krahasuar me planin e 2015-ës në vlerë absolute planifikimi i fillimvitet është rritur me 84.144.000 lekë ose 32% më shumë se viti paraardhës. Pavarësisht se dihen

tashmë kufizimet që qeveria qendrore i ka bërë pushtetit vendor në drejtim të mbledhjes së të ardhurave konkretisht në tatimfitimin e thjeshtuar për tatimpaguesit, sërish është vërejtur progres.

Duke parë analizën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, por edhe punën e bërë gjatë vitit të kaluar, kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, i ka përgëzuar punonjësit e kësaj drejtorie në përgjithësi për rezultatet që kanë qenë pozitive. Megjithatë, në krahasim me vitin 2015, ka disa tregues ku drejtorja duhet të punojë më shumë. Ai propozoi që të ndërmerren hapa konkretë në mënyrë të detajuar dhe të gjenden instrumentet e duhura për mbledhjen e taksave familjare. Edhe pse ka pasur rritje të numrit të bizneseve, kjo nuk është pasqyruar në proporcionalisht në rritjen e të ardhurave nga këto subjekte. Duhet këmbëngulur më shumë në zhdukjen e informalitetit për sa u përket bizneseve, për të cilat duhet pasur edhe një bazë të dhënash e plotë dhe e saktë. Ndërkaq, një pjesë e rëndësishme e punës së kësaj drejtorie është edhe zbatimi i paketës fiskale. Tjetër problematikë është

Krahasuar me një vit më parë, me realizimin faktik të vitit 2015, të ardhurat faktike të realizuara për vitin 2016 janë në vlerë absolute 57.238.102 lekë më shumë se fakti i vitit të kaluar ose rreth 29% më shumë. Ky tejkallim fakt me fakt është realizuar proporcionalisht për çdo zë të taksave si ato të biznesit edhe ato të kategorisë familjare përjashtuar tatimfitimin e thjeshtuar. Misioni i kësaj drejtorie është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim rritjen e të ardhurave, shmangien e evazionit fiskal dhe uljen e numrit të subjekteve debitore nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe ndërtimit të marrëdhënieve me taksapaguesit. Objekt i taksave dhe tarifave vendore janë bizneset (person fizik/juridik) si dhe taksat vendore (kategoria familjare).

Punonjësit e Njësive Administrative Paskuqan, rol të rëndësishëm në shërbimin ndaj qytetarëve 2016

Në analizën e punës njëvjeçare të Njësive Administrative të Paskuqanit, kryebashkiaku Xhelal Mziu dha vlerësim pozitiv për shumicën e punonjësve të kësaj njësie. Ata kanë rol të rëndësishëm, sepse kanë përballje të drejtpërdrejtë me qytetarët e Paskuqanit, meqenëse më shumë sesa 60% e popullsisë vijjnë në këto zyra. Ai i falënderoi për punën e bërë në vitin e kaluar. Ndër çështjet e diskutuara gjatë analizës ishte informaliteti për sa u përket lejeve të banimit, sistemi i adresave, debitit e trashëguara, taksat familjare dhe detyrimet për ujësjellësin. Ndihma ekonomike në zonën e Paskuqanit ka shifra jo të kënaqshme. Duhet sa më shumë aplikime të familjeve dhe për këtë rol të madh luajnë punonjësit e Njësive Administrative të Paskuqanit. Duhet oponencë konkrete për çdo familje që është hequr padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike. Partneriteti të shtrihet edhe me shkollat, duke krijuar mundësi komunikimi me mësuesit dhe nxënësit për të qenë sa më pranë tyre për çdo problem dhe zgjidhjen e tyre dhe duke denoncuar çdo aspekt abuziv. Po ashtu, bashkëpunimi duhet të vijojë edhe me shoqata të ndryshme. Ndërkaq, edhe sistemi i informatizimit duhet të përfshijë të gjithë infrastrukturën e Njësive, si dhe të jetë i lidhur tërësisht me Bashkinë në Kamëz dhe me njësinë e shërbimeve administrative në Bathore. Z. Mziu kërkoi angazhim maksimal nga çdo punonjës, të jenë bashkëpunues me qytetarët. Cilësia e shërbimit e ofruar nga kjo njësi ka ardhur në rritje. Nga punonjësit e Njësive është punuar intensivisht edhe për rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, kjo nëpërmjet ndërgjegjësimit të qytetarëve për shlyerjen e detyrimeve ndaj Njësive Administrative. Zyra e Gjendjes Civile, ajo e Arkës, zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, zyra e Ndihmës Ekonomike janë disa nga zyrat në One Stop Shop-in e Njësive që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, për të cilët kanë dhënë maksimumin për t'u ofruar shërbime cilësore.

Drejtorja Administrative Njësia Bathore, kryebashkiaku Mziu vlerëson punën njëvjeçare të saj

Gjatë analizës së punës njëvjeçare të Drejtorisë Administrative Njësia Bathore, kryebashkiaku Xhelal Mziu dha një vlerësim pozitiv për risitë që ka sjellë. Pavarësisht nga ndryshimi i performancës në krahasim me vitin 2015, z. Mziu tërhoqi vëmendjen për disa çështje, duke filluar që nga etika e komunikimit me qytetarët, veshja, disiplina etj., të cilat në njëfarë mënyre ndikojnë në marrëdhënien me komunitetin, duke qenë kështu edhe pasqyrë e institucionit të Bashkisë. Ndërkaq, kryebashkiaku Mziu u shpreh se meqenëse një pjesë e madhe e popullsisë vijjnë në këto zyra për shërbime apo probleme të ndryshme, ata duhet të gjejnë zgjidhjen pikërisht te këta punonjës, duke ofruar shërbim korrekt e të shpejtë. Edhe për sa i përket ndihmës ekonomike, z. Mziu kërkoi që të bëhej më shumë në këtë drejtim, për të bërë të mundur që rritet numri i familjeve që aplikojnë, me qëllimin që të përfitojnë sa më shumë familje nga kjo skemë. Për këtë duhen shfrytëzuar disa faktorë, siç është, së pari, dalja në terren; së dyti shfrytëzimi i sistemit GIS, por edhe ndërlidhësit me komunitetin. Kreu i Bashkisë kërkoi bashkëpunim jo vetëm me qytetarët, por edhe me çdo faktor tjetër, siç janë shoqatat e ndryshme, institucionet arsimore, kulturore, fetare etj., me qëllim që ky bashkëpunim të shkojë në dobi të komunitetit të banorëve.



Kryebashkiaku Mziu vlerëson punën e Drejtorisë së Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial

Në analizën e Drejtorisë së Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial, kryebashkiaku Xhelal Mziu vlerësoi punën e bërë nga stafi i kësaj drejtorie gjatë vitit 2016. Edhe pse në një censurë të vendosur nga ana e instrumenteve shtetërore, Drejtoria e Koordinimit shfrytëzoi të gjithë infrastrukturën për të përfutur projekte me peshë për institucionin e Bashkisë dhe një impakt shumë të vlefshëm për qytetarët e Kamzës. Edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha për të ruajtur elementet e bashkëpunimit me aktorë strategjikë, siç janë: Banka Botërore, aplikimet dhe përfitimet e projekteve të BE-së, KfW, si dhe shumë aktorë të tjerë.

Z. Mziu vlerësoi se duhet punuar edhe me partnerë të tjerë të njohur, me qëllimin e vetëm për të përfutur bashkëpunime të rëndësishme për t'i shërbyer me përkushtim komunitetit të Bashkisë Kamzë. Të tilla mund të përmendim aplikime për projekte me përfitimet financiare siç janë bankat e niveleve të dyta, bizneset e ndryshme, kompanitë imobilare, ambasadat e akredituara në Shqipëri, si dhe shumë e shumë aktorë strategjikë të cilët jo vetëm do të kenë një peshë në investimet e projekteve në fusha të ndryshme. Gjithashtu z. Mziu theksoi se duhen pasur gjithmonë parasysh edhe qytetet me të cilat Bashkia ka realizuar binjakëzimet. Njëkohësisht edhe OJF-të janë një burim tjetër i shfrytëzueshëm bashkëpunimi dhe përfitimi.

Në fund z. Mziu theksoi se fokusi i drejtorisë duhet të jetë orientimi i institucionit të Bashkisë për gjetjen e rrugëve për përfitimet dhe financimin e projekteve për t'i shndërruar



në investime dhe shërbime për qytetarët e Kamzës.

Gjatë vitit 2016, Drejtoria e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial ka kryer një veprimtari të gjithanshme dhe intensive, në përputhje me planin e saj vjetor, të hartuar në fillim të vitit. Falë projektit “Pjesëmarrja qytetare e të rinjve dhe vullnetarizmi”, Drejtoria e Koordinimit, Zhvillimit dhe Projekteve në kuadër të thellimit të bashkëpunimeve të mëtejshme ndërkombëtare bëri të mundur që Bashkia Kamzë të nënshkruante marrëveshje ndërkombëtare me bashkitë: Liberi – Itali; Vecpiebalga – Letoni; Riebini – Letoni; Roccamonfina – Itali; Bashkia Presenzano

– Itali. Në kuadër të projektit “Lidhjet për ligjshmërinë - Angazhimi demokratik dhe pjesëmarrja qytetare”, Bashkia Kamzë nënshkroi marrëveshje ndërkombëtare me bashkitë: San Nicola La Strada – Itali; Powiat Dabrowski – Poloni; Slowenka Darmoty – Slloveni; Klos – Shqipëri; Cesa – Itali; Casapulla – Itali. Tjetër arritje e kësaj drejtorie ishte edhe aplikimi në programin për çmimin e KE-së “European Green Capital Award 2019” - “Kryeqyteti i Gjellbër i Evropës 2019”. Drejtoria e Koordinimit-Zhvillimit dhe Protokollit Ceremonial aplikoi në Projektin e Komisionit Evropian “Creative Europe” (2014-2020). Drejtoria e Koordinimit-Zhvillimit dhe Protokollit Ceremonial

Falë projektit

“Pjesëmarrja qytetare e të rinjve dhe vullnetarizmi”, Drejtoria e Koordinimit, Zhvillimit dhe Projekteve në kuadër të thellimit të bashkëpunimeve të mëtejshme ndërkombëtare bëri të mundur që Bashkia Kamzë të nënshkruante marrëveshje ndërkombëtare me bashkitë: Liberi – Itali; Vecpiebalga – Letoni; Riebini – Letoni; Roccamonfina – Itali; Bashkia Presenzano – Itali.

aplikoi në thirrjen e katërt dhe të pestë për propozime IADSA dhe u kualifikua në dy fazat e para. Drejtoria e Koordinimit-Zhvillimit nëpërmjet rrjetit të kontakteve me Agjencinë Evropiane të Biznesit EBA, Britani e Madhe, ka bërë të mundur çeljen e negociatave për bashkëpunim në fushën e arsimit nga rrjeti i Cempaka Schools në Malajzi, për ndërtimin e një kolegji në Kamzë.

Drejtorja e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, mbështetëse dhe këshilluese e çdo drejtorie në Bashkinë Kamzë

Kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, vlerësoi punën e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike për punën e bërë vitin e kaluar dhe kërkoi që kjo drejtori të shërbejë si drejtori mbështetëse në shërbim të të gjitha drejtorive të tjera të institucionit të Bashkisë, për realizimin sa më efikas të detyrave të tyre funksionale. Gjatë zhvillimit të analizës vjetore të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike kërkoi që të jenë edhe më koherente me ligjin dhe aktet



nënligjore të cilat kanë të bëjnë me pushtetin vendor. Rëndësi të veçantë kryebashkiaku Mziu u kushtoi edhe problemeve ende të pazgjidhura, siç është identifikimi i pronave publike dhe gjetja e hapësirave ligjore për fitimin e titullit të pronësisë, duke i dhënë destinacionin përkatës.

Drejtorja e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike duhet të japë asistencën

e plotë në zbatimin e paketës fiskale. Sa u përket prokurimeve, z. Mziu kërkoi uljen e shpenzimeve operative të panevojshme për kursim, për realizimin e investimeve. Në fund të analizës kreu i Bashkisë kërkoi që drejtoria të bëjë avokatinë e institucionit për të gjitha rastet abuzive ndaj saj.

Gjatë vitit 2016, Zyra Juridike, krahasuar me vitin 2015, ka pasur rritje të numrit të shkresave zyrtare të cikluara për Zyrën Juridike, pasi viti 2016 korrespondonte si viti i parë pas zbatimit të reformës territoriale; rritje të shkresave zyrtare të dërguara institucioneve të ndryshme qendrore, vendore, kjo për shkak të rritjes së zhvillimeve progresive në fusha të ndryshme në të cilat operon Bashkia Kamzë; si dhe rritje të numrit të proceseve gjyqësore.

Problematikë ka qenë mosbashkëpunimi i institucioneve qendrore përkatëse, si ZVRPP-ja, AKP-ja dhe ALUIZN-i, për konfirmimet dhe kthimet e përgjigjeve zyrtare, si kusht për zbatimin e VKM-ve të sipërcituara, çka ka sjellë dhe mospërfundimin e plotësimit të dosjeve përkatëse dhe dërgimin e tyre në Këshillin e Qarkut apo lidhjen e kontratave të privatizimit, edhe pse janë dërguar rreth 27 shkresa zyrtare drejtuar këtyre institucioneve qendrore.

Kryebashkiaku Mziu: Gjendja Civile, drejtori e cila është e përditshme në përballjen me qytetarët

Drejtorja e Shërbimeve Administrative One Stop Shop dhe Zyra e Gjendjes Civile është një drejtori në përballjen të përditshme me qytetarët. Kështu e nisi fjalën e tij kryebashkiaku Xhelal Mziu gjatë analizës 1-vjetore të kësaj drejtorie. Pasi vlerësoi punën e saj, ai tha që çdo sjellje e krijon kosto për Bashkinë, kështu që kërkoi shumë disiplinë në punë në përballjen me qytetarët. Ai e vuri theksin edhe tek komunikimi, i cili është mjet themelor i tyre me qytetarët.

Ndër problematikat kryesore që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, janë detyrimet ligjore me regjistrin e territorit, lejet e vendbanimeve të të gjithë atyre që banojnë në Kamzë, por nuk e kanë lejen e banimit këtu. “Duhet patjetër të gjeni instrumentet ligjore, që personat t'i sjellin lejet e banimit. Akoma vuajmë sistemin e adresave, kështu që kërkoj një formular standard për të gjitha. Patjetër duhet zhdurk informaliteti në sistemin e adresave dhe të lejeve të banimit. Ndërsa sa u përket personave që punojnë tek One Stop Shop-i, duhet të profilizohen, në mënyrë që të mos ketë sorollatje të asnjë qytetari”, - u shpreh ndër të tjera z. Mziu.

Si dhe vitet e tjera, kërkesat kanë qenë në rritje, ndaj Gjendja Civile ka përballuar një volum të madh pune.

Përgjatë vitit që lamë pas, janë emtuar të paktën 127.550 certifikata në të tria zyrat së bashku: Kamzë, Bathore e Paskuqan, si dhe



janë kryer edhe një sërë veprimesh të tjera ligjore.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar procesi i saktësimit të sistemit të adresave të familjeve që jetojnë në territorin e Bashkisë Kamzë. Shërbimi në One Stop Shop ka qenë në nivelin e duhur, duke i paraprirë nivelit të përgjithshëm të institucionit të Bashkisë Kamzë. Gjatë gjithë vitit 2016 është përballuar një fluks i madh qytetarësh. Çdo ditë në sportelet e One Stop Shop-it u është shërbyer me formular shërbimi mesatarisht 162 qytetarëve.

Gjithashtu, gjatë çdo javë pranë sportelit të One Stop Shop, janë pranuar mesatarisht 187 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, duke arritur një shifër vjetore 8991 kërkesë/ankesa, të cilat janë shqyrtuar dhe kanë marrë zgjidhje nga vetë kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me drejtorit të tjerë të institucionit të Bashkisë.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu, i pranishëm në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i pranishëm në mbledhjen e radhës të Komitetit Drejtues të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, që u organizua nën kujdesin e kryetarit të Bashkisë Pogradec, z. Eduart Kapri, në mjediset e kësaj Bashkie. Në këtë takim u prezantuan aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer në një hark kohor prej 12 muajsh gjatë vitit 2016.

Në zbatim dhe të statutit të Shoqatës, Komiteti Drejtues diskutoi dhe miratoi raportin vjetor dhe atë financiar si dhe planin e saj të aktiviteteve për 2017, në pasqyrim dhe të problematikave të bashkive. Kryebashkiakët evidentuan çështje lidhur me vështirësitë financiare me buxhetin e akorduar për vitin 2017, buxhet i cili në vijimësi nuk reflekton realitetin bashkiak të nevojave për shërbime dhe pas miratimeve të ndryshimeve thelbësore në organizim dhe funksionim. Shqetësim i vazhdueshëm mbetet edhe ndarja e fondeve nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, ku bashkitë e djathta, edhe pse konkurrojnë me projekte dinjitoze, nuk kanë gjetur mbështetje nga qeveria



sikundër bashkime e mazhorancës. Probleme të tjera ishin: mungesa e ligjit për financat vendore, kuadri ligjor sekondar për arsimin parashkollor, për funksionet e tjera të reja, problematikave me inspektoratet dhe agjencitë

qeveritare, problematika me ligjin e pyjeve, si dhe çështja e borxheve të trashëguara që ka vënë në vështirësi të mëdha bashkitë për investime dhe shërbime publike qoftë në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale etj. Shoqata

Shqetësim i vazhdueshëm mbetet ndarja e fondeve nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, ku bashkitë e djathta, edhe pse konkurrojnë me projekte dinjitoze, nuk kanë gjetur mbështetje nga qeveria sikundër bashkime e mazhorancës.

e Bashkive do të ngrejë zërin e kryetarëve për korrektimin e këtyre praktikave abuzive nga institucionet qendrore.

Nga ana e tyre, bashkitë angazhohen në ofrimin e shërbimeve sa më efikase sa më afër qytetarëve, me burimet e veta financiare.

Kryeministri nuk fton kryebashkiakun Mziu në takim me kryetarët e bashkive për projektet dhe bashkëpunimin me vendorët

Vijon diskriminimi nga ana e Kryeministrit hakmarrës për kryebashkiakun, Bashkinë dhe qytetarët e Kamzës

Kryetarët e bashkive të vendit u thirrën në një takim në Kryeministri nga kreu i qeverisë, por Edi Rama nuk thirri kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu. Ky Kryeministër hakmarrës vijon të diskriminojë jo vetëm



Bashkinë, kryebashkiakun e saj, por edhe qytetarët e Kamzës, duke harruar që Kamza është Bashkia e gjashtë në shkallë vendi. "Programi i Rilindjes Urbane është një urë shumë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe bashkive", - qe shprehur Kryeministri, por këtë frymë bashkëpunimi nuk e ka shtrirë te bashkitë e djathta, veçanërisht te Bashkia e Kamzës, të cilën për katër vjet rresht e ka diskriminuar, jo vetëm si institucion, por edhe qytetarët e saj. Më absurde dhe më e dhimbshme bëhet kjo, kur mendon se në këtë qytet nuk jetojnë vetëm demokratë, por edhe qytetarë të bindjeve të majta apo bindjeve të tjera, të cilët e vuajnë diskriminimin e këtij Kryeministri hakmarrës. Ritheksojmë edhe një herë, në 4 vjet kjo qeveri nuk ka akorduar asnjë fond apo financim për rreth 130 projekte të paraqitura qeverisë. Ndoshta mosthirrja e kryebashkiakut Xhelal Mziu në këtë takim vjen për këtë shkak, pasi asnjë qindarkë nuk i është dhënë njësisë vendore që drejton z. Mziu për tri mandate rresht. Vijon kështu ende që të mos ketë frymë bashkëpunimi nga ana e qeverisë, pavarësisht nga nevojat që kanë banorët e Kamzës dhe të Paskuqanit për investime publike në fusha jetike për ta.

Konferenca e Këshillit të Evropës/ Bashkia Kamëz, një nga pesë praktikantët më të mira në vend

Bashkia Kamëz është cilësuar si një ndër bashkitë me praktikantët më të mira në vend. Ky vlerësim ka ardhur në konferencën "Kërkimi dhe advokimi sigurojnë politika më të mira evropiane në Shqipëri", zhvilluar në "Tirana International Hotel", organizuar nga Këshilli i Evropës, Akademia e Studimeve Politike, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

Bashkia Kamëz, e cila në këtë konferencë u përfaqësua nga sekretari i Përgjithshëm i saj, z. Qemal Çejku, ishte një nga pesë praktikantët më të mira në vend. Punimi "Monitorimi i procedurave të prokurimit publik në Bashkinë Kamëz dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor" solli në vëmendje të Këshillit Evropës dhe Akademisë së Studimeve Politike një model të mirë dhe një praktikë që sot është në funksionim në vende të Bashkimit Evropian.

Në këtë konferencë u prezantuan pesë punime kërkimore me fokus monitorimin e politikave në nivel vendor, e cila mbledhi së bashku vendimmarrës, politikëbërës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

Diskutimi i gjetjeve të këtyre punimeve me aktorët kryesorë synoi replikimin e shembujve pozitivë në njësi të tjera vendore si dhe përmirësimin e praktikave të hasura përgjatë vitit të parë të zbatimit të reformës administrative-territoriale.

Këto punime kërkimore u përgatitën me mbështetjen nga alumë (ish-pjesëmarrës) të Akademisë së Studimeve Politike, të cilët veprojnë si promotorë të ndryshimit dhe të zbatimit të reformave të rëndësishme integruese në vend. Punimet u vlerësuan nga aktorët e ndryshëm të ftuar në këtë konferencë si një angazhim i duhur i profesionistëve dhe qytetarëve aktivë për të përmirësuar problematikave që shfaqen dhe ndikojnë në mirëqeverisjen vendore.

Më konkretisht punimet kërkimore që u prezantuan ishin: "Monitorimi i procedurave të prokurimit publik në bashkinë Kamëz dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor"; "Monitorimi i standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ndërhyrjet infrastrukturore të vitit 2015-2016 të Bashkisë Tiranë"; "Evidentimi i shembullit pozitiv të Bashkisë Korçë për punësimin e personave "të dënuar në shërbim prove" dhe "ish të dënuar"; "Monitorimi i situatës së transferimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore në Bashkinë Tiranë pas reformës administrative-territoriale"; "Vlerësimi i mënyrave për të përfshirë komunitetet rurale bregdetare në administrimin e plazheve të Rivierës Shqiptare". Akademia e Studimeve Politike (ASP) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2009, nën kujdesin e Këshillit të Evropës, me synim nxitjen e një brezi të udhëheqësve të rinj politikë dhe shoqërisë civile. ASP është struktura përgjegjëse për organizimin në Shqipëri të programit Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike me kontributin financiar të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Saktësimi i adresave, Bashkia Kamëz, masa për zbatimin në kohë të udhëzimit të Ministrisë së Brendshme

Bashkia Kamëz ka kohë që ka marrë masa për zbatimin e udhëzimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për saktësimin e adresave për qytetarët e saj. Këto masa kanë të bëjnë edhe me identifikimin e zgjedhësve dhe që në zgjedhjet për Kuvend të 18 qershorit të mos ketë më votues pa adresë të saktë. Në ambiente të ndryshme të Bashkisë dhe të njësisë administrative të saj është afishuar edhe udhëzimi përkatës i Ministrisë së Brendshme që çdo qytetar të informohet për këtë udhëzim dhe rëndësinë e saktësimit të adresës.

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.89/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar, me qëllim zbatimin e një procesi unik të pasqyrimin të adresës, Bashkia Kamëz ka bërë njoftimin e qytetarëve të saj në vende publike të udhëzimit nr. 622, datë 11.11.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pranë zyrave të Gjendjes Civile në Bashkinë Kamëz, në njësinë administrative Bathore dhe njësisë administrative Paskuqan për "Miratimin e modelit të adresës dhe radhën e vendosjes së elementeve të saj". Në udhëzimin përkatës janë përshkruar elementet e specifikuar për zbatimin e një procesi unik të pasqyrimin të adresës si dhe për t'u ardhur në ndihmë të gjitha institucioneve publike/private, personave juridikë e fizikë lidhur me modelin e adresës dhe renditjen e elementeve të saj. Bashkia Kamëz ka vënë në funksion të gjithë mekanizmat për të bërë njoftimet përkatëse dhe zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi.



Kryebashkiaku Mziu: Rritje e aplikimeve dhe oponente ligjore për refuzimet e padrejta të familjeve për ndihmë ekonomike

Janar 2017
GAZETA KAMZA

5



Fokusi kryesor i punës së Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale duhet të jetë rritja e aplikimeve të familjeve për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike, si dhe oponenta ligjore dhe mediatike për refuzimet e bëra në mënyrë të padrejtë. Kështu është shprehur kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, gjatë analizës së punës njëvjetore të Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Për të pasur sa më shumë aplikime, sipas z. Mziu, duhet të shfrytëzohen edhe shumë struktura të tjera mbështetëse, siç janë ndërlidhësit me komunitetin. Duke vlerësuar punën e bërë nga kjo drejtori në 2016-ën, z. Mziu tha se ka bërë përmirësim në



“Refuzimi i këtyre familjeve është bërë pa dhënë argumente, edhe pse kanë qenë trajtuar më parë me ndihmë. Numri më i madh i tyre është refuzuar për mosplotësim pikësh, por pa u argumentuar.”



krahasim me të kaluarën, por duhet reflektuar në disa momente. Ai theksoi se është absurde

që janë 2600 familje të refuzuara, gjysma prej të cilave për shkak të pikavarazhit. Duhet sqaruar se cili është sistemi i pikëzimit dhe cilat janë arsyet për refuzimin e këtyre familjeve. Duhet sqaruar edhe qytetarët se nuk është Bashkia ajo që vendos, por Ministria. Një tjetër absurditet është se si mund të marrin e të përdorin dekoderë dixhitalë këto familje, kur nuk kanë as televizorë apo pajisje të tjera elektroshtëpiake! Duhet të ketë një

listë të saktë të familjeve të cilat janë poshtë minimumit jetik, sepse ka me mijëra prej tyre që janë shkualifikuar nga skema e qeverisë për të marrë ndihmë ekonomike. Duhet informacion i plotë dhe argumentues për familjet përfituese dhe jopërfituese. Duhet parë nëse refuzimi është i padrejtë apo jo. Refuzimi i këtyre familjeve është bërë pa dhënë argumente, edhe pse kanë qenë trajtuar më parë me ndihmë. Numri më i madh i tyre

është refuzuar për mosplotësim pikësh, por pa u argumentuar. Duhet theksuar se në vitin 2016, Bashkia ka dhënë ndihma emergjence nga të ardhurat e veta. Ndërkaq, fondi për personat me aftësi të kufizuara, për invaliditetin ka qenë në rritje për vitin 2016, ndërsa numërohen edhe 32 nxënës dhe 30 studentë me aftësi të kufizuara që janë trajtuar me ndihmë. Një element tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe bashkëpunimi i kësaj drejtorie me organizata joqeveritare apo me shoqata të ndryshme.

Familja Mateli, një nga mijëra familje të Kamzës, që padrejtësisht nuk trajtohet me ndihmë ekonomike nga qeveria

Pavarësisht se çdo muaj aplikon, kjo nuk merret fare parasysh nga qeveria që e refuzon vazhdimisht t'i japë ndihmë ekonomike

Familja e Petrit Matelit, një familje shumë e varfër, e cila jeton në kushte të mjerueshme, është e përbërë nga 5 anëtarë, burri, bashkëshortja dhe 3 fëmijë. Të dy janë të papunë, ndërsa të tre fëmijët janë në shkollë dhe të tre fëmijët janë të sëmurë, kjo për shkak të lëngështirës së madhe që ka brenda në shtëpi dhe mungesa e ushqimit. Prej 8 muajsh i është ndërprerë

znj. Mateli, - ndërsa tani më faturojnë çdo muaj nga 65 mijë lekë pavarësisht që unë ndez vetëm një dush, pasi s'kam gjëra të tjera. Kam bërë disa herë ankesa në lidhje me këtë, por askush nuk më ka dhënë ndihmë". Më tej, Afërdita Mateli bën këtë thirrje: "Kërkoj të më ndihmoni me shtëpi, pasi të tre fëmijët i kam të sëmurë, për shkak të kushteve të mjerueshme që ka shtëpia, dhe është e pamundur për të jetuar në këtë shtëpi. Kam 10 vjet që kërkoj ndihmë për shtëpi, pasi më janë sëmurë për shkak të lagështirës dhe kushteve të këqija. Kërkoj edhe një pension, sepse jemi të paafte, si unë ashtu edhe bashkëshorti im, si dhe fëmijët i kam në shkollë, por i kam të sëmurë. Djali i madh e kam me astmë, ndërsa vajza ka nevojë për operacion sepse vuan nga cistet dhe nuk kam mundësi ta operoj".



ndihma ekonomike, për shkak se bashkëshorti i Afërdita Matelit ka punuar dy muaj në një fabrikë ku është paguar 70 mijë lekë të vjetra. Pavarësisht se çdo muaj aplikon, kjo nuk merret fare parasysh nga qeveria që e refuzon vazhdimisht t'i japë ndihmë ekonomike. Arsyet janë të kota. "Kam kërkuar ndihmë nga qeveria, por ata s'kanë bërë asnjë lloj veprimi për të më ndihmuar", - thotë ajo. Është e paafte për të punuar, pasi në vitin 2007 ka pësuar një aksident. "Kam ndenjur prej 8 muaj pa energji elektrike, - vijon

Bashkia Kamëz, me mundësitë e veta, ka qenë gjithnjë pranë shtresave në nevojë. Megjithatë, fondet që duhen për të ndihmuar familjet e qytetit janë të papërbalueshme nga ana e saj. Ndërkaq, nga ana e qeverisë, e ministrive të linjës dhe e autoriteteve të tjera qendrore ka pasur një indiferencë të pashpjegueshme, madje duke hequr edhe mijëra familje në mënyrë të padrejtë nga skema e trajtimit me ndihmë ekonomike, siç është edhe rasti i familjes Mateli.

Vetëvrasja e 31-vjeçarit në Kamëz për faturat e energjisë, tjetër tragjedi për "meritë" të "Rilindjes"

Një tjetër tragjedi për "meritë" të "Rilindjes" u shënuar në qytetin e Kamzës. Për shkak të pamundësisë për të paguar faturën e energjisë elektrike, një 31-vjeçar, baba i një fëmije, i ka dhënë fund jetës. Duke mos pasur asnjë mundësi për të paguar një shumë prej 80 mijë lekësh të reja, për shkak të kushteve të vështira ekonomike, Klajdi Muça i ka dhënë fund jetës. "Ku kam mundësi të paguaj kaq para? Veç të vras veten...", - ishin fjalët e 31-vjeçarit në zyrën e OSHEE-së në Kamëz, të cilat i kanë dëgjuar edhe qytetarë të tjerë. Kështu, në vend që të kontribuonte në zhvillimin e vendit, "Rilindja" ka bërë të kundërtën këto vite. Jo vetëm që nuk kanë mbajtur premtime, por e kanë bërë Shqipërinë një vend ku nuk jetohej më, qytetarët e të cilit si zgjidhje të vetme kanë braktisjen e tij apo më keq akoma, siç ndodhi edhe me Klajdi Muçën, braktisjen e jetës, dhënien fund të saj. Dhe kjo, për "meritë" të "Rilindjes".

Mbledhja e Këshillit Bashkiak, miratohen disa vendime me ndikim social për qytetarët e Kamzës

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak për muajin janar, u miratuan disa vendime me ndikim të ndjeshëm social për qytetarët e Kamzës. Mes projektvendimeve që u paraqitën për votim përpara këshilltarëve të qytetit të Kamzës, bënin pjesë projektvendime me anë të cilave bëhet e mundur ndihmesa e shtresave të familjeve në nevojë, ndihmesa për personat me aftësi të kufizuara, kompensimi për pagesën e energjisë elektrike, dhënia e bursave për nxënësit dhe studentët e Kamzës etj. Kështu, nga ana e anëtarëve të Këshillit Bashkiak u miratua projektvendimi për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31.1.2017; projektvendimi për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31.1.2017 për personat me aftësi të kufizuara; projektvendimi për rastet e veçanta për muajin janar 2017; projektvendimi për dhënien e kompensimit të energjisë elektrike për muajin dhjetor 2016; projektvendimi për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për familjen e z. Sokol Kol Qehaja; projektvendimi për miratimin e skemës për pagesën me këste të detyrimit të abonentëve të Ujësjellësit; projektvendimi për dhënien e bursave të shtetit nxënësve të viteve të para, të dyta dhe të treta për vitin mësimor 2016-2017; projektvendimi për dhënien e bursave të shtetit për studentët e viteve të para për vitin akademik 2016-2017 etj.



Urbanistika, kryebashkiaku Xhelal Mziu: Mënyra e menaxhimit ka dhënë impakt tek kjo drejtori

Në analizën e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve, kryebashkiaku Xhelal Mziu u shpreh se mënyra e menaxhimit ka dhënë impakt tek kjo drejtori, duke u bërë më koherente. Ndërkaq, z.Mziu kërkoi unifikimin e standardit të projekteve, sipas atyre bashkëkohore, si dhe standard më të lartë të kontrollit dhe zbatimit të projekteve, duke bërë një oponencë të vazhdueshme në këtë aspekt.

Një problem tjetër ishte edhe një bazë e plotë të dhënash të rrugëve, KUN-ve etj., me të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të përditësuar. Duhet bërë azhurnimi i dy planeve urbanistike, Kamëz e Paskuqan, duke ndërmarrë hapa konkretë për të shkuar drejt njësimi të tyre në një të vetëm. Sistemi i plotë i adresave ishte një tjetër problematikë e diskutuar; po ashtu edhe emërtimi i rrugëve, kodifikimi i banesave, si dhe përfundimi me sukses i sistemit GIS.



Të tjera çështje tek të cilat vuri theksin z. Mziu ishte edhe hapja e hapësirave publike, lejet e ndërtimit, pronat, situata debitorë etj.

Gjatë vitit 2016, sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve u zbatuan

të gjitha detyrat, projektzbatimet dhe studimet e njëpasnjëshme të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e jetës dhe kushteve sociale të komunitetit të qytetit të Kamzës.

Ndër momentet më të rëndësishme të punës së Drejtorisë së Planifikimit,

Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve gjatë vitit 2016 mund të përmendim:

-aplikimi online në e-Albania i projekteve sipas KZHR (Fondet për Zhvillim Rajonal);

-bashkëpunim me donatorët e huaj për financim investimesh; kontrolli i realizimit të investimeve të kryera gjatë kësaj kohe; realizimi i projektzbatimeve për buxhetin e vitit 2017;

-bashkëpunimi me drejtoritë e tjera për financim investimesh; aplikimi i lejeve të ndërtimit online në e-Albania;

-shqyrtimi dhe kërkesat për lejet e ndërtimit; zbatimi i planit rregullues të qytetit të Kamzës dhe Paskuqanit; -bashkëpunimi me ALUIZNI-n për vazhdimësinë në procesin e legalizimit;

-shqyrtimi i ankesave dhe problemeve të ndryshme të qytetareve; krijimi i regjistrit të territorit në sistemin GIS në bashkëpunim me USAID-in etj.

Ndërtimi i rrugës “Mësonjëtorja” në lagjen 5 Kamëz, një nga 50 projektet e reja të Bashkisë për vitin 2017



Ndërtimi i rrugës “Mësonjëtorja” në lagjen nr. 5 në Kamëz është një nga 50 projektet e reja të Bashkisë Kamëz për vitin 2017. Ashtu si edhe vitet e kaluara, Bashkia, duke u mbështetur vetëm në të ardhurat e veta, do të realizojë investime publike në infrastrukturën rrugore dhe në infrastrukturën nëntokësore në disa lagje të qytetit. Pjesë e këtyre ndërhyrjeve në infrastrukturë, duke u bazuar edhe në kërkesat e banorëve, është edhe ndërtimi i rrugës “Mësonjëtorja”, me parametra: gjatësi L=258 ml, b=4.5 + 2 x 0.5 ban. Projekti i hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve përmban standarde bashkëkohore. Por më e rëndësishmja është se do t'u shërbejë një numri të konsiderueshëm banorësh të kësaj lagjeje, duke lehtësuar kështu kalimin në këtë rrugë, si për këmbësorët ashtu edhe për automjetet.

Investimet në infrastrukturë, së shpejti nis ndërtimi i rrugës “Tomin” në lagjen 3 Bathore

Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturën rrugore do të përfshijnë çdo pjesë të qytetit. Kështu, së shpejti do të nisë ndërtimi i rrugës “Tomin” në lagjen 3 nr. Bathore. Megjithëse pjesa më e madhe e investimeve do të përqendrohet sërish në zonën e Paskuqanit, edhe lagjet e tjera të Bashkisë Kamëz nuk do të përjashtohen nga realizimet e projekteve të hartuara për vitin 2017. Rruga “Tomin”, prej së cilës do të përfitojnë banorët e lagjes nr. 3 në Bathore, do të jetë e gjatë 300 ml. Qytetarët e kësaj zone do të jenë kështu përfitues të një investimi të rëndësishëm, i cili do të ketë ndikim të madh social. Së pari, bën të mundur përmirësimin e kushteve të infrastrukturës urbane dhe lehtësimin e kalimit në këtë segment dhe së dyti, me krijimin e kësaj infrastrukture, bëhet i mundur edhe zhvillimi i bizneseve. Si rrjedhojë, do të ketë më shumë të punësuar dhe më shumë përfitime financiare për banorët e rrugës “Tomin” në Bathore.



Rruga “Abdi Bej Toptani” në Valias - një investim i dobishëm për komunitetin e banorëve të zonës



Një investim i dobishëm për komunitetin e banorëve të zonës do të jetë realizimi i projektit për ndërtimin e rrugës “Abdi Bej Toptani” në Valias, me gjatësi 1400 ml.

Me gjerësi 10 ml, me kuletë 0.5 ml dhe trotuare në të dyja anët e rrugës me nga 2 ml gjerësi, kjo rrugë do të kthehet në një segment me parametra bashkëkohore.

Duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e mijëra qytetarëve të zonës, në prioritetet e Bashkisë Kamëz për vitin 2017 është edhe ndërtimi i kësaj rruge me gjatësi të konsiderueshme dhe që ndikon si në aspektin social ashtu edhe në atë ekonomik.

Kjo, për vetë faktin se realizimi i këtij investimi të rëndësishëm do të ndikojë në shtimin e numrit të bizneseve, duke qenë një nga rrugët kryesore të Kamzës dhe që bën lidhjen e disa lagjeve të këtij qyteti ndërmjet tyre, por edhe me zonat përreth.



Vlerësime pozitive për punën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Dekorit, Strehimit, Emergjencave Civile dhe Krizave

Kryebashkiaku Xhelal Mziu vlerësoi në mënyrë pozitive punën e bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Dekorit, Strehimit, Emergjencave Civile dhe Krizave. Janë bërë hapa përpara krahasuar me vitet e mëparshme në punën e kësaj drejtorie për vitin 2016. Drejtoria e Shërbimeve Publike është një nga drejtoritë më të mëdha në Bashki. Poredhe pse janë bërë zhvillime konkrete dhe me reformën territoriale janë shumë punë për t'u bërë kryesisht në shërbimet që mbulon kjo strukturë, duhet pasur një angazhim më të madh.



Kështu, duhet të ketë një database të saktë për çdo element struktural siç mund të jenë të dhëna të sakta për strukturat ndërvartëse që janë Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, ajo e Pastrim-Gjelbërimit, OSHEE-ja, Dekorimi apo Zjarrfikëset. Këto do të ndihmojnë për ta vendosur punën e Bashkisë në kornizat e duhura për të realizuar objektivat që përbëjnë prioritetet në shërbime. Kështu, dihet që Kamza është një qytet me një sipërfaqe territoriale me rreth 41 km². Kamza ka rreth 35.000 familje nga të cilat kanë furnizim me ujë 15.000 familje me burime ujore brenda territorit dhe 4000 familje furnizohen nga Tirana. Pjesa tjetër furnizohet me burime alternative siç mund të jenë puset arteziane. E parë në këtë aspekt, duhet të administrohet dhe menaxhohet më mirë situata e furnizimit me ujë për

popullatën. Një tjetër aspekt mbetet për t'u vlerësuar dhe shërbimi i pastrimit ku duhet të përcaktohen saktë normat e prodhimit ditor, mujor dhe vjetor për të pasur të qartë situatën në këtë shërbim si dhe organizimi më i mirë i tij. Një tjetër aspekt është furnizimi me energji elektrike i cili duhet të administrohet me rigorozitet. Këtu jo pak peshë luan Drejtoria e Shërbimeve Publike për sa u përket 30 shkollave dhe 10 institucioneve të tjera shtetërore që janë brenda të territorit të Bashkisë për të bashkëpunuar me OSHEE-në për konsumin si dhe kontrollin e saktë për licencimin e linjave të transmetimit si dhe zgjidhja e problemeve jo të pakta me shtyllat. Strehimi është një element tjetër mjaft i ndjeshëm për këtë drejtorinë. Duhet përcaktuar saktë elementët e dosjes për

trajtimin ligjor të familjeve të pastreha. Zjarrfikëset, një kompetencë që është kaluar te pushteti vendor, por mjeti ende i papranishëm në Bashki. Duhet të shihet me prioritet funksionimi sa më i qartë i këtij sektori. Perspektiva sjell një ngjeshje të detyrave, por zbatim i ligjit do të bëjë të mundur realizimin e funksioneve që mbart kjo drejtori.

Gjatë vitit 2016 në listën e punëve të kësaj drejtorie janë përfshirë shumë operacione dhe shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e imazhit të institucionit dhe ofrimit të zgjidhjeve reale për qytetarët.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar inspektimit të rrjetit të infrastrukturës rrugore, punimeve që po kryhen për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, sa i përket rikthimit të rrjetit rrugor në gjendjen e mëparshme, në të gjitha zonat ku janë kryer këto ndërhyrje. Gjithashtu, përmirësimin e ndriçimit të hapësirave të qytetit, si në rrugët kryesore dhe sheshet publike.

Është bërë një reagim i menjëhershëm për përballimin e situatës emergjente në Bashkinë Kamëz. Me urdhër të kryetarit të Bashkisë, u ngritën 3 grupe pune për evidentimin dhe konstatimin e dëmeve të shkaktuara

“ Është bërë një reagim i menjëhershëm për përballimin e situatës emergjente në Bashkinë Kamëz. Me urdhër të kryetarit të Bashkisë, u ngritën 3 grupe pune për evidentimin dhe konstatimin e dëmeve të shkaktuara në të gjithë territorin e saj. U bë gjithçka që brenda kuadrit ligjor në fuqi të plotësoheshin të gjitha dosjet sipas procesverbaleve të konstatimit. ”

në të gjithë territorin e saj. U bë gjithçka që brenda kuadrit ligjor në fuqi të plotësoheshin të gjitha dosjet sipas procesverbaleve të konstatimit, të sjellë nga grupet e punës, dhe është hartuar projektvendimi për 418 familjet e përmbytura të datës 8 nëntor 2016 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.

OSHEE rrezikon jetën e banorëve të Bashkisë Kamëz, duke mos përmbushur detyrimet ndaj konsumatorëve



Drejtorja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kamëz risjell në vëmendje të opinionit publik një rast flagrant të papërgjegjshmërisë institucionale të kompanisë OSHEE, që ka neglizhuar totalisht kërkesën zyrtare të këtij institucioni, në lidhje me vënien në dijeni për ndërhyrje të menjëhershme për zëvendësimin e dy shtyllave të dëmtuara në hyrje të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka” në Bathore në rrugën “Demokracia”. Dëmtimi i tyre përbën një rrezik serioz për jetën e nxënësve të asaj shkolle dhe kalimtarëve të rastit në atë rrugë. Me shkresën nr. 5830, datë 28.10.2016, Bashkia Kamëz i është drejtuar zyrtarisht Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Tirana 3, duke i paraqitur konkretisht shqetësimin e prindërve të nxënësve të asaj shkolle, por edhe komunitetit për problemin në fjalë, së bashku me fotot ilustruese që janë bërë në vendngjarje, por neglizhenca dhe papërgjegjshmëria deri më tani ka qenë e paprecedentë.

Pavarësisht se kanë kaluar tre muaj nga kërkesa zyrtare e institucionit të Bashkisë për marrjen e masave të menjëhershme për të zëvendësuar shtyllat e dëmtuara, deri më sot asnjë përpjekje minimale nuk është ndërmarrë nga ana e tyre. OSHEE kujdeset për faturat e kripura në kurriz të qytetarëve, mbifaturime dhe prerjen e furnizimit me energji elektrike shtesave në pamundësi ekonomike, duke u kthyer në një “vegël” presioni e qeverisë sa herë ajo e thërret në detyrë për aksione ndëshkuese ndaj qytetarëve të Bashkisë Kamëz, por nuk përmbush detyrimet minimale që ka për funksion si detyrim për kontratën që ka me konsumatorët e këtij qyteti.

Ujësjellës-Kanalizimet, tolerancë zero ndaj informalitetit

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz ka zhvilluar analizën e punës së vitit 2016. Në fjalën e tij, pas prezantimit të analizës, kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, e vlerësoi punën e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, duke shtuar se duhet të jetë një ndërmarrje shërbimi me të gjitha parametrat e duhur, në shërbim të qytetarëve. Nga kryetari i Bashkisë u kërkuar tolerancë zero ndaj informalitetit, gjë që vërehet në disa lagje të qytetit, si dhe duhet një bazë e saktë dhe e plotë të dhënash për 35 mijë familjet e qytetit dhe për bizneset, e cila të jetë koherente dhe e përditësuar. Ndërkaq, është trashëguar një situatë debitorë për shkak të informalitetit. Për sa u përket detyrimeve, z. Mziu tha se pagesat për shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve nuk krahasohen me faturat e padrejta të energjisë elektrike. Në një muaj, për energji elektrike qytetarët paguan më shumë sesa paguan për gjithë vitin për ujin dhe kanalizimet bashkë, që janë shërbime jo vetëm për një lagje apo zonë të caktuar, por për të gjithë qytetin dhe banorët e tij. Paketa fiskale nuk është abuzuese, por e favorshme, si për familjet ashtu edhe për bizneset. Dhe më e rëndësishmja është se këto të ardhura shkojnë për investime publike, kryesisht në rrjetin e KUN-ve. Gjatë vitit 2016, nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve është punuar në disa drejtime, siç është zgjerimi i zonave të mbulimit me ujë në Kamëz e Paskuqan; lufta ndaj informalitetit në çdo sektor; rritja e kapaciteteve dhe e burimeve njerëzore; rritja e performancës ekonomike të ndërmarrjes; vjelja e debive në vite; bashkëpunimi me sportelet e One Stop Shop-it në Kamëz, në njësitë administrative Bathore dhe Paskuqan; bashkëpunimi i ngushtë me kompaninë KfW; plotësimi dhe saktësimi i adresave për klientët; raporti i monitorimit të performancës. Ndërmarrja e Ujësjellësit tashmë është drejt finalizimit të projektit të ujësjellësit në bashkëpunim me kompaninë zbatuese “Strabag” për t'i dhënë zgjidhje problemit të furnizimit me ujë të qytetit. Ndërmarrja ka pasur progres dhe në rritjen e përgjegjshmërisë të çdo punonjësi sipas kriterëve dhe normave administrative. Falë punës së ndërmarrjes, janë shtuar 1700 abonentë dhe një ndër rrisitë ka qenë edhe fatura elektronike. Për sa u përket ankesave gjatë vitit 2016, ato kanë qenë rreth 700 të tilla në muaj, të cilave u është dhënë zgjidhje.

Pastrim-Gjelbërimi, ndërmarrje e rëndësishme, për shkak të shërbimeve ndaj qytetarëve

Edhe puna e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit gjatë vitit 2016 është vlerësuar nga kryebashkiaku Xhelal Mziu. Në materialin e prezantuar nga drejtori i Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, Qemal Metalia, disa nga çështjet e analizuar ishte cilësia e shërbimeve që u është ofruar qytetarëve gjatë vitit që kaloi, shtimi i sipërfaqes së mbjellë, situata e përmbytjeve, volumi i transportit të mbetjeve urbane, të ardhurat në vite, shpenzimi i buxhetit të parashikuar për këtë ndërmarrje etj. Duke vlerësuar punën e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, u shpreh se është një ndërmarrje e rëndësishme, për shkak të shërbimeve ndaj qytetarëve. Prioritet, sipas tij, mbetet që asnjë lagje, asnjë rrugë, asnjë rrugicë, asnjë shtëpi të mos ngelet jashtë skemës së pastrimit. Po ashtu, asnjë lloj mbetjeje të mos ketë në hapësirat publike, në mënyrë që të ketë një mjedis të pastër dhe që të mos prishet imazhi i qytetit. Ndërkaq, z. Mziu kërkoi që të ketë bashkëpunim edhe me bizneset. Fillimisht atyre u duhet ofruar shërbimi cilësor nga ana e ndërmarrjes, por të bashkëpunohet për mbajtjen pastër të mjedisit me bizneset, të këshillohen për këtë e, madje, në rast shkeljesh, edhe të gjobiten, në përputhje me ligjin. Një bashkëpunim të tillë u kërkuar edhe me shkollat, që të kontribuojnë së bashku për një qytet më të pastër. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren edhe fushata ndërgjegjësimi dhe publicitare të përbashkëta në rrugë apo lagje të caktuara për orientimin se si duhet vepruar me mbetjet.



Kamza Karate nis stërvitjen intensive për vitin 2017, me synim arritjen e objektivave

Pas sukseseve të njëpasnjëshme për vitin 2016 ekipi i Kamza Karate nis stërvitjen intensive në drejtimin e trajnerit Luftar Kurti për vitin në vijim, me synim arritjen e objektivave të vendosur në këtë fillim viti. Viti 2017 do të jetë një vit i mbushur plot aktivitetesh të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe adrenaline për Kamza Karate.

Në një intervistë me trajnerin e ekipit të Kamza Karate, z. L U F T A R Kurti, pasi falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të kryebashkiakut Xhelal Mziu dhe bashkëpunimin me Bashkinë Kamëz, shpalosi edhe objektivat për vitin 2017 si dhe aktivitetet që do të marrë pjesë. “Duke pasur parasysh se tashmë sporti i karatesë është sport olimpik dhe të frymëzuar nga rezultatet e ekipit tonë për vitin e kaluar, tashmë synimet tona për 2017, përveçse aktivitetet kombëtare që jam i bindur që Kamza do të jetë përsëri fitues i Kampionatit dhe Kupës, janë aktivitetet ndërkombëtare, pasi përfaqësimi i sportistëve të karatesë në Lojërat Olimpikë 2020 në Tokio të Japonisë bëhet me grumbullim pikësh. Objektivi për ne



janë aktivitetet ndërkombëtare si Kampionati Ballkanik, Kampionati Evropian më 3-4 qershor, i cili do të mbahet në Prishtinë, Kampionati Botëror më 26-29 tetor, i cili mbahet në Tenerife të Spanjës, si dhe shumë turne të tjerë ndërkombëtarë që mbahen në shtete fqinje, të cilat janë aktivitetet

rëndësishme dhe tregues për përmirësimin dhe nivelin e sportistëve tanë për rezultate më të larta në Kampionatin Ballkanik, Evropian dhe Botëror, pasi këto janë aktivitetet që kanë më shumë pikë. Nëse do të ketë përfaqësues karateja në Lojërat Olimpikë 2020, ai do të jetë sportisti i Kamza Karate”.

Luftar Kurti: Nëse karateja do të ketë përfaqësues në Lojërat Olimpikë 2020, ai do të jetë sportisti i Kamzës; “Kamza Karate Open”, tashmë traditë në këtë qytet.

Si çdo vit sportistët e Kamza Karate do të marrin pjesë në të gjitha turnetë ndërkombëtarë që zhvillohen në Greqi, Maqedoni, Kosovë, Serbi dhe në Malin e Zi, si dhe në organizimin e turneut ndërkombëtar “Kamza Karate Open”, tashmë traditë për qytetin e Kamzës në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz dhe mbështetjen e kryetarit të Bashkisë, z. Xhelal Mziu.

Basketbollistët e Kamza Basket, të përgatitur për t'u përballur me çdo kundërshtar në fazën e dytë

Ekipi i meshkujve Kamza Basket po stërvitet rregullisht në këtë periudhë. Kështu shprehet për gazetën “Kamza” trajneri i këtij ekipi, z. Adem Muhametaj. Ai thotë se edhe në ditët më të ftohta, me temperatura nën zero, stërvitja ka vijuar dhe nuk është ndërprerë puna asnjë sekondë. Për këtë duhen falënderuar djemtë për punën që kanë bërë dhe po bëjnë aktualisht. Në fakt, sipas z. Muhametaj, të gjitha ekipet e Kamzës në basketboll kanë vazhduar punën në periudhën e merkatos së janarit.

Ekipet rivale kanë zhvilluar merkato me kosto mjaft të lartë, duke afruar pranë tyre edhe basketbollistët të huaj. Por, siç shprehet trajneri Adem Muhametaj, edhe Kamza po pret lëvizjet e tyre, ndërkohë që po shohin edhe mundësitë e veta për lëvizje në merkato.

“Gatishmëria e vazhdueshme për kujdes dhe trajtim sa më cilësor të sportistëve dhe për ndërhyrje, nëse ka nevojë, edhe në merkato, na bën ne që të punojmë me besim dhe dëshirë”, - shprehet ndër të tjera z. Muhametaj. Ndërkaq, ai thekson se ekipet e moshave vazhdojnë kampionatet, duke zhvilluar ndeshje me nivel të lartë. Mes tyre, ekipi U18 i Kamzës kryeson grupin pa asnjë humbje dhe është pretendent kryesor për të fituar kampionatin. Edhe ekipet e vajzave po stërviten vazhdimisht dhe po rritet dita-ditës cilësia e lojës së tyre.

“Me gjithë forcimin e ekipeve rivale, pavarësisht nga merkatoja e fuqishme e tyre, ne jemi përballur me shumë dinjitet e nivel, duke pasur në gjirin e ekipit të Kamzës sportistë nga ky qytet, nga zona të ndryshme të tij.

Kjo ka qenë edhe motoja e sivjetshme në grupet tona: afrim i talenteve nga Kamza dhe masivizim i basketbollit, me qëllimin për të rritur cilësinë e këtij sporti”, - shprehet në fjalën e tij trajneri i Kamza Basket, Adem Muhametaj, duke thënë në fund se falënderon Bashkinë Kamëz dhe kryebashkiakun Xhelal Mziu për ndihmën e vazhdueshme dhe krijimin e një infrastrukture bashkëkohore për sportin, por sidomos për basketbollin.



Trajneri Adem Muhametaj. Edhe në ditët më të ftohta, me temperatura nën zero, stërvitja ka vijuar dhe nuk është ndërprerë puna asnjë sekondë.

BASHKIA KAMËZ

Informacione	Çmime Ndërkombëtare	Partneritete
<ul style="list-style-type: none"> • Sipërfaqe 40.357.000 m² • Popullsia mbi 140,000 • Atraktive për biznesin, mbi 2400 • Moshë mesatare 27 vjeç • Sistem i plotë adresash • Rrugë të asfaltuara mbi 160 km • One Stop Shop • Pallati i Kulturës, Stadiumi etj... 	<p>Bashkia me praktikat më të mira kërkimore, ESQR Bruksel 2014</p> <p>“Çmimi i Sokratit” EBA Oxford 2014</p> <p>Menaxhuesi më i mirë i qytetit</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Kontakte</p> <p style="text-align: center;">www.kamza.gov.al</p> <p style="text-align: center;">f bashkiakamez</p> <p style="text-align: center;">f xhelalmziu</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bashkimi Europian Banka Botërore USAID KfW GIZ Macerata, Itali Jena, Gjermani Galway, Irlandë

Adresa: Bulevardi “BLU” Nr 492 Kamez, tel: +355 47 200 177, e-mail: bashkiakamez@gmail.com, www.kamza.gov.al